

UDHËZIM
Nr. 5, datë 27.2.2020

**PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE
TË ARSIMIT FILLOR 2020**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 22 maj 2020, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre.

3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.

4. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.

5. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor 2020”.

6. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.

7. Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

9. Arkivimi i testeve bëhet pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar.

10. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit (QVT) dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.

11. Ngarkohet, për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini